



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE DHE TË ULËT DREJTUESE**

Lloji i diplomës " Shkenca Juridike ", niveli minimal i diplomës "Master Profesional"/ Master Shkencor".

Në zbatim të Nenit 26, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, dhe III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18/03/2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", Institucioni I **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** shpall Procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë në Shërbimin civil, në pozicionin:

1. Inspektor në Drejtorinë e Hetimit Administrativ – Kategoria e pages: III-a

Pozicioni i më sipërm, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

16.07. 2023

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

21.07 .2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Përbush detyrimet ligjore duke zbatuar gjatë veprimtarisë së punës së tij përcaktimet e parashikuara në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe ushtron funksionin e tij me përgjegjshmëri dhe efikasitet.
2. Krijon dosjen përkatëse për hetimin administrativ të çështjeve të ngarkuara, në përbërje të së cilës administrohen urdhrin përkatës të Komisionerit, procesverbalin e mbajtur në prezencë të palëve për kryerjen e hetimit administrativ, provat shkresore, burimin e krijimit të tyre si dhe relacionin shpjegues mbi çmuarjen e tyre me konkluzionet dhe nënshkrimin përkatës. Aktet e administruara në këtë dosje përgatiten nga drejtoria dhe i referohen standarteve të unifikuara të formave shkresore, të miratuara nga Komisioneri.
3. Zbaton planin e inspektimit të miratuar, lidhur me hetimin administrativ që do të kryhet.
4. Kryen inspektime për shqyrtimin e ankesave të ardhura pranë institucionit dhe kur i kërkohet nga Komisioneri, për problematika të ndryshme kur ka informacion dhe njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut.
5. Zbaton planin e kontrollit për përbushjen e sanksioneve me gjobë të dhëna nga Komisioneri, me përjashtim të rastit kur nevojitet kryerja e veprimeve për ekzekutim nga Drejtoria Juridike.
6. Trajton ankesat e ardhura pranë Institucionit me profesionalizëm dhe brenda afateve kohore të parashikuara në ligj.
7. Mban kontakte me palët për paraqitjen e provave dhe parashtrimeve pas regjistrimit të çështjes.
8. Merr masa për organizimin në kohë të seancave dëgjimore publike, duke ftuar palët dhe çdo person tjetër që ka interes për çështjen.
9. Çdo dosje e trajtuar, brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, i përcillet eprorit.
10. Përgatit informacion dhe raporte periodike për Komisionerin, lidhur me shqyrtimin e ankesave nga Drejtoria Hetimit Administrativ.
11. Merr pjesë në grupe të ndryshme pune në sektorë të ndryshëm, që hartojnë strategji kombëtare dhe lokale.
12. Marrja pjesë dhe dhënia e kontributit në grupet e punës, seminare, trajnime.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni).
- c- Të kenë të paktën dy vlerësimet e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional ose Shkencor " në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b- Të kenë të paktën 7 vite përvojë pune në administratën publike në fushën e të drejtave të njeriut.
- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
- d- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b - Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g – Dy Vlerësimet e fundit të punës;
- h- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të

kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

k.-Letër motivimi për aplikim në vendin vakant

l- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit

ll- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-ivetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>

Kandidati duhet të dorëzojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit Nr. 27, (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë **Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077. e- mail: www.info@kmd.al dokumentat e sipër përmendur):**

Dokumentat për procedurën e lëvizjes paralele duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejt brenda datës: 16.07.2023

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20.07.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në faqen zyrtare të KMD-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit ".

- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"
- Ligjin nr. 9970/2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"
- Ligj nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara"
- Ligji nr.139, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore", *i ndryshuar*

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3(tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3(tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (www.kmd.al), dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” .

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar në një kategori më të ulët
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni)
- c- Të kenë të paktën dy vlerësimet e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional ose Shkencor " në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b- Të kenë të paktën 7 vite përvojë pune në administratën publike në fushën e të drejtave të njeriut.
- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
- d- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit të punës;
- h- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
- i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- k.-Letër motivimi për aplikim në vendin vakant
- l- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit
- ll- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>
- m- Të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.1

**Kandidati duhet të dorëzojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit Nr. 27, (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë
Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: www.info@kmd.al
dokumentat e sipër përmendur):**

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës: 21.07.2023

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KMD—së dhe shërbimit kombëtar të punësimit duke filluar nga data: 28.07.2023

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 28.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njësia e burime njerëzore të KMD-së , për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit " .
- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjin nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”
- Ligj nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”
- Ligji nr.139, datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njesia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatit e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPND) për rezultatit e pikëve brenda 3(tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatit e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Njësia Përgjegjëse

Ana MUÇA

Bajram BAKALLI